



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 196/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Sali Toplica, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Dalibor Vasiq nga iniciativa qytetare Gragjanska Iniciativa Zavicaj dega në Partesh, që ka të bëjë me kërcënim, në seancën e panelit të mbajtur me 16 Korrik 2010, mori këtë:

V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

A R S Y E T I M I

Z. Dalibor Vasiq nga Iniciativa Qytetare Gragjanska Iniciativa Zavicaj dega në Partesh, ka parashtruar ankesë më datë 06.07.2010, me të cilën pretendon se Z. Blagoje Karadzic për një kohë të gjatë është duke e ngacmuar dhe keqtrajtuar verbalisht për arsye se është aktiv në këtë iniciativë qytetare. Parashtruesi i ankesës mendon se prapa kësaj qëndron një kandidat nga subjekti tjetër politik që garon për kryetar komune.

F A K T E T

Më 07 korrik 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Z. Dalibor Vasiq nga Iniciativa Qytetare Gragjanska Iniciativa Zavicaj dega në Partesh. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur ngacmime dhe keqtrajttime verbale nga ana e kandidatit për kryetar komune në Partesh Blagoje Karadziq.

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi si provë lidhur me ngacmimin dhe keqtrajtimin, vetëm se ka cekur emrat e Dejan Jolic, Srdan Stolic dhe Srecko Cvetkovic si dëshmitar.

A N A L I Z Ë

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Ligji Për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP (Ligji nr 03/L- 073) neni 118.1 dhe Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parasheh si vijon:

118.1 KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

3.6 (b) Një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi mjerranë posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e nenit 3.6 pika (b) dhe pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 196/2010 më datën 16 Korrik 2010.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

